

## Forcimi i kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizimit në burgje në Ballkanin Perëndimor

### Cili është qëllimi i projektit?

Të kontribuojë në sigurinë rajonale duke adresuar radikalizimin në burgje dhe duke i shkëputur të burgosurit e dënuar për ekstremizëm të dhunshëm nga dhuna përmes:

- ▶ rritjes së ndërgjegjësimit për procesin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe inkurajimit të një kulture të shkëmbimit të informacionit e praktikave të mira mes institucioneve penitenciare dhe shërbimeve të provës
- ▶ asistimit të profesionistëve në shquarjen e shenjave të radikalizimit dhe fuqizimin e oficerëve të vijës së parë me pajisjen e tyre me njohuritë dhe mjetet e nevojshme
- ▶ mundësisimit dhe inkurajimit të partneriteteve mes shumë agjencive për t'iu kundërvënë radikalizimit në burgje dhe për të ofruar mbështetjen e duhur pas vuajtjes së dënimit penal për të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm të liruar nga burgju

### Kush përfiton nga ky projekt?

- ▶ Ministritë e Drejtësisë së Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës\*, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë
- ▶ Shërbimet penitenciare dhe shërbimet e provës
- ▶ Mekanizmat kombëtarë të koordinimit për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit
- ▶ Institucione dhe agjenci të tjera të rëndësishme
- ▶ Të burgosurit e rrezikuar, të burgosurit e radikalizuar dhe të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm
- ▶ Shoqëria në përgjithësi

### Si do të funksionojë projekti?

Ky projekt ofron një forum për shkëmbim njohurish, përvojash dhe mësimesh të nxjerra mes vendeve përfituese për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në burgje. Ai ka për qëllim të kontribuojë në standardizimin e qasjeve të ndërmarra në Ballkanin Perëndimor dhe në vendosjen e standardeve minimale dhe metodologjive të unifikuara për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në burgje në rajon. Ky projekt koordinon masat e tij me autoritetet e vendeve përfituese (burgjet dhe shërbimet e provës), si dhe me mekanizmat lokalë të koordinimit për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe antiterrorizmit.

### Çfarë presim të arrijë ky projekt?

- ▶ Zbatim më të mirë të mjeteve dhe mekanizmave nga profesionistët sa i përket adresimit të radikalizimit në burgje nga këndvështrimi i praktikave të mira të identifikuar në rajon dhe në Evropë;
- ▶ Përmirësim të kapaciteteve të profesionistëve të përfshirë në identifikimin dhe luftën ndaj radikalizimit në burgje;
- ▶ Aftësimin e drejtuesve të burgjeve dhe stafit të burgjeve në Serbi dhe në Kosovë për të identifikuar, për të vlerësuar dhe për të adresuar radikalizimin në punën e tyre të përditshme përmes zbatimit sistematik të metodologjive dhe mjeteve të sapo zhvilluara.

## Sa do të kushtojë ky projekt?

- ▶ Buxheti total i këtij projekti është 2.000.000 Euro
- ▶ Buxheti i caktuar për programin e Instrumentit Horizontal shkon rreth 41 milionë Euro (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës).

## Si të marrim më shumë informacion?

- ▶ Faqja e internetit e Njesisë për Bashkëpunim në fushën e të Drejtës Penale: <https://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop>
- ▶ Faqja e internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Marija Simić, Këshilltare e Instrumentit Horizontal për Komunikimin, [Marija.SIMIC@coe.int](mailto:Marija.SIMIC@coe.int), +381 63 601 337  
Besnik Baka, Këshilltar i Instrumentit Horizontal për Komunikimin, [Besnik.BAKA@coe.int](mailto:Besnik.BAKA@coe.int), +355 69 217 8430

## Rreth Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një nismë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u jep mundësi vendeve përfutuese të përmbushin axhendat e tyre të reformave në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë dhe në arritjen e standardeve evropiane, në kuadrin e procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar mbulon projektet në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Turqi dhe në Kosovë\* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës që prej muajit maj 2019.

*\*Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.*

Këshilli i Evropës është organizata lider e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bëjnë së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të qëndrueshëm, duke ruajtur në të njëjtën kohë diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vende dhe popuj përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

*Kjo fletëpalosje është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të asnjërës palë.*

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

CONSEIL DE L'EUROPE